



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:271322

Datë: 11.02.2021

Numri i dokumentit: 01499733

C.nr.955/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me praktikanten e kësaj gjykate Liridona Uka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve 1. V. K., 2. F. Q. dhe 3. S. K., që të gjithë nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson Fitim Gashi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, Gjakovë, me objekt të padisë kompensimin e pagave për përcjellje në pension, shpërblim jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtave), vlera e kontestit 1.000,00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 26.01.2021, i përpiluar me dt.11.02.2021, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve 1. V. K., 2. F. Q. dhe 3. S. K., që të tre nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, që:

1. Paditëses V. K., nga Gjakova, të ia paguaj borxhin në emër të tri paga mujore me rastin e pensionimit shumë prej 1.416.75 €, në emër të shpërblimit jubilar për 42 vite përvoje pune shumë prej 708.37 € dhe në emër të kompensimit për ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjer më datë 23.09.2019, për ditët totale të pranisë në punë prej 424 ditë (dhe atë për secilën ditë të pranisë në punë shumë nga 2 euro) shumë prej 848 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej **2.973.12 €**, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 26.01.2021, e deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit.

2. Paditëses F. Q., nga Gjakova, të ia paguaj borxhin në emër të tri paga mujore me rastin e pensionimit shumë prej 772,56 € dhe në emër të shpërblimit jubilar për 41 vite përvoje pune shumë prej 386,28 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej **1.158.84 €**, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 26.01.2021, e deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit.

3. Paditësit S. K. nga Gjakova, të ia paguaj borxhin në emër të tri paga mujore me rastin e pensionimit shumë prej 1.463.07 €, në emër të shpërblimit jubilar për 43 vite përvoje pune shumë prej 731.53 €, dhe në emër të kompensimit për ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjer më datë

02.01.2019, për ditët totale të pranisë në punë prej 298 ditë (dhe atë për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) shumën prej 596 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej **3,058.80** €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 26.01.2021, e deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses V. K., nga Gjakova, për kompensimin e ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë, mbi shumën e aprovuar 848 € për 424 ditë, si në dispozitiv nën I pika 1 të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar 914,00 €, për 457 ditë si dhe pjesa e kërkesëpadisë së paditësit S. K. nga Gjakova, mbi shumën e aprovuar 3.058,80 € si në dispozitiv nën I pika 3 e këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar 3.376,80 €, REFUZOHET si e pa bazuar.

III. Padia e paditëses F. Q., nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, për kompensimit e ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjer më datë 08.01.2019, për ditët totale të pranisë në punë prej 298 ditë, në shumën prej 596 €, KONSTATOHET e TERHEQUR.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, që paditësve 1. V. K., 2.F. Q. dhe 3. S. K., që të gjithë nga Gjakova, që të gjithë nga Gjakova, të iu kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 498,40 €, në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Seanca kryesore është mbajtur konform nenit 423.4 të LPK-së.

Paditësit në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre Fitim Gashi, avokat nga Prishtina, kanë parashtruar padi me dt.20.11.2019 për kompensimin e pagave përcjellëse në pension, shpërblimin jubilar dhe kompensimin e ushqimit (shujtave), kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit-Gjakovë. Në referatin e padisë kanë theksuar se paditësja V. K., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 1977, si mësimdhënëse në SHMU “Zef Lush Marku”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.23.09.2019, kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 42 vite. Paditësja F. C., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 1978, si mësimdhënëse në Gjimnazin “Hajdar Dushi”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.08.01.2019, kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 41 vite. Paditësi S. K., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për 43 vite, si mësimdhënëse në SHMU “Ali Hasi”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.02.01.2019, kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 43 vite. Paditësit si të punësuar tek e paditura si dhe duke qenë anëtarë të SBASHK-ut, e cila është nënshkruese e kontratës kolektive të dt.18.04.2017, me Ministrinë e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Republika e Kosovës, të njëjtës në baze të dispozitivit nga neni 35 par.8 dhe 9 të kësaj kontrate kolektive, ju takon shpërblimi jubilar 150% të një page baze, pasi që kanë përvoja pune mbi 40-43 vite, si dhe tri paga përcjellëse. Sipas kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht e IV që ka të beje me Rregullat e Përgjithshme dhe Pagat, neni 35 par. 7 thekson se: “ Te punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjate punës, për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një dite pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”. Pasi që e paditura deri në ditën e ushtrimit të kësaj padie, paditësve nuk i ka paguar pagat si shpërblim jubilar e as

pagat përcjellëse pas pensionimit, si dhe as shujtën për ushqim ditor nga koha e hyrjes ne fuqi te kontratës kolektive me dt. 18.07.2017, deri ne kohen e pensionimit te tyre me dt.02.01.2019,08.012019 dhe 23.09.2019 kur te njëjtit kane dal ne pension, atëherë paditësit i propozojmë kësaj gjykate qe ne baze te nenit 90. Par 5 te Ligjit te Punës dhe nenit 35 par, 7,8 dhe 9 te Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosovë dhe pas administrimit te provave ne shqyrtim kryesor te bie këtë Aktgjykim, të aprovohet kërkesëpadia e paditësve si e bazuar dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës, që paditësve ti kompensoj shpërblimin jubilar, pagat përcjellëse në pension si dhe shujtën ditore, të precizuar në kërkesëpadi.

I autorizuari i paditësve në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe deklarimeve nga seanca e kaluar me q' rast e njoftoj gjykatën se vërtetimin për ditët e punës për paditësen F. Q. për te cilën kemi pasur obligim qe ta sjellim ne këtë seance e njoftojmë gjykatën se këtë vërtetim nuk kemi arritur ta sigurojmë pasi qe paditësja u arsyetua me faktin se e njëjta ka probleme shëndetësore dhe nuk ka mundur qe ta siguroj andaj konsiderojmë qe gjykata ne baze te provave tjera qe gjenden ne shkresat e lendes sa i përket paditëses F. Q., mund ta vërtetoj te drejtën e saj sa i përket shpërblimit jubilar si dhe tri pagesave përcjellëse ndera sa i përket pagese se ushqimit (shujtave) për ditët ne pune nga kjo kërkesë tërhiqemi ne mungese te provës konkrete. Ndërsa për te tjerat mësim si ne padi. Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi nga provat e administruara u vërtetua kërkesëpadia si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia e saj andaj i propozojmë gjykatës qe kërkesëpadinë e precizuar ta aprovoj ne tersi si te bazuar dhe atë me kamate ligjore 8% dhe atë nga dorëzimi i kërkesëpadisë te dt.20.11.2019 deri ne pagesën përfundimtare. Gjithashtu kërkoj qe gjykata ta obligoj te paditurën qe te paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë për përpilimin e padisë 208 euro, për 2 seanca te mbajtura nga 270.40 euro, si dhe për takse gjyqësore ne shumen prej 20.00 euro, gjithsejtë totali 768.80.

E paditura në përgjigje në padi të dhënë pas afatit ligjore me dt.20.05.2020 ka theksuar duke qenë se padinë e tillë të paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakove, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, brenda afatit ligjor e autorizuara e të paditurës paraqet këtë përgjigje në padi. Sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi të drejtat dhe detyrat e personalit të punësuar në Ministrinë e Arsimit janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili ka hyrë në fuqi me dt.01. Nëntor 2010, i cili Ligj nuk ka paraparë asnjë beneficion apo privilegj për personat të cilëve ju është ndërprerë marrëdhënie e punës sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës së pensionimit (neni 67 paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 i Ligjit nr. 03L-212 i Punës) ndërsa ende është në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut numër 2001/35 e dt. 22 Dhjetor 2001 dhe Rregullorja 2005/20 e dt. 29 prill 2005, për ndryshimin e Rregullores numër 2001/35 mbi pensionet në Kosovë e cila me nenin 4 paragrafin 1 parashikon se administrata udhëheq dhe administron pagesën e pensioneve bazë, për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët arrijnë moshën e pensionimit dhe paragrafit 2 i nenit të cekur parasheh shumën e pensionit bazë e cila përcaktohet sipas metodologjisë të cilën e miraton Kuvendi i Kosovë. Kontrata Kolektive është e lidhur me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Odës Ekonomike të Kosovës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt. 01 janar 2015 andaj për të aplikuar dispozitën e nenit 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive ka qenë deshtë që Federata Sindikale E Organeve të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të ketë lidhur kontratë të posaçme me punëdhënësin e vet. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka lidhur kurrfarë kontrate kolektive me Federatën e Punëtorëve të Arsimit dhe në këtë kontest nuk ka kurrfarë obligimi për të zbatuar dispozitën e Kontratës Kolektive e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt. 01 janar 2015. Ish Ministri i MASHT-it z. Ramë Buja me Kryetarin e SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj me dt.11 Prill 2014 kanë nënshkruar Kontratën Kolektive të Arsimit Para Universitar, ku sipas nenit 2, zbatimi i kontratës është për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe privat të arsimit

para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) në mbarë territorin e republikës së Kosovës të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Në nenin 36 rregullohet garantimi i pagave dhe sipas pikës 9 anëtarë punëtorët (anëtarë të SBSSHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar siç ka kërkuar paditësja por Kontrata nuk është e zbatueshme dhe nuk mund të ketë efekt retroaktiv. (Kontrata Kolektive e dt. 11 prill 2014 është shfuqizuar sipas nenit 48 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18/04/2017). Bazuar edhe në Kontratën e Kolektive e Arsimit në Kosovë të nënshkruar me dt.18/04/2017, në mes të z. Arsim Bajrami Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe z.Rrahman Jasharaj Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ju njoftojmë se përkundër neni 46 të kësaj kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate të Ministrisë së Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. Ka propozuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin e vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Zef Lush Marku” numër të protokollit 92/01 dt.11.09.2019, kopjen e ekstraktit nga regjistri qendror i gjendjes civile lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Gjakovë, dt.24.10.2019, vendimin e lëshuar nga MPMS Departamenti i pensioneve me dt.16.10.2019, njoftimin e lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit me dt.25.10.2019, me referencë Zyrt. 04-120/01-39861, vërtetimin e lëshuar nga SBASHK-u për V. K. me dt.07.11.2019, i nënshkruar nga kryetari S. M., pasqyrën e llogarisë Bankare lëshuar nga Raiffeisen Bankë për paditësen V. K., dt.28.10.2019, vërtetimin e lëshuar nga Gjimnazi “Hajdar Dushi” Gjakovë, nr.3019 dt.10.06.2019, i nënshkruar nga drejtori B. C., vërtetimin e lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë nr. 03/156 dt.04.07.2019, ekstraktin e lindjes lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë dt.07.02.2014, kopjen e librezës së punës për paditësen F. Q., vërtetimin e lëshuar nga SBASHK-u, për F. Q. me dt.07.11.2019, i nënshkruar nga kryetari S. M., vendimin e lëshuar nga MPMS Departamenti i pensioneve me dt.16.01.2019, vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Ali M. Hasi” Cermjan-Gjakovë, nr.1157 dt.28.10.2019, i nënshkruar nga drejtori R. H., vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Ali M. Hasi” Cermjan-Gjakovë, nr.1251 dt.23.12.2020, nënshkruar nga drejtori B. S., vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Zef Lush Marku” Brekoc-Gjakovë, numër të protokollit 108/01 dt.23.12.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e administruara në mënyrë të gjithmbarshme, u vërtetua fakti se është jo kontestuese në mesë palëve se paditësja V. K., nga Gjakova, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në SHMU “Zef Lush Marku”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.23.09.2019, kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 42 vite. Gjithashtu është jo kontestues fakti se paditësja F. C., nga Gjakova ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në Gjimnazin “Hajdar Dushi”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.08.01.2019, kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 41 vite si dhe paditësi S. K., nga Gjakova, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për 43 vite, si mësimdhënëse në SHMU “Ali Hasi”, Gjakovë dhe aty ka punuar deri me dt.02.01.2019,

kur ka arritur moshën 65 vjeçare-moshën e pensionimit dhe ka përvojë pune 43 vite. E paditura nuk i ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësve. Po ashtu u vërtetua se paditësja V. K., në muajt e fundit para pensionimit ka realizuar page mujore në vlerë prej 472,25 €. Paditësja F. C., në muajt e fundit para pensionimit ka realizuar page mujore në vlerë prej 257,52€, ndërsa paditësi S. K. ka realizuar pagë mujore 487.69€.

Me vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Ali M. Hasi” Cermjan-Gjakovë, nr.1251 dt.23.12.2020, nënshkruar nga drejtori B. S., u vërtetua se paditësi S. K. nga Gjakova, prej dt.18.04.2017 e deri me dt.28.12.2018 konofrm kalendarëve tanë të punës, ka punuar për gjithsejtë 310 ditë pune.

Me vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Zef Lush Marku” Brekoc-Gjakovë, numër të protokollit 108/01 dt.23.12.2020, gjykata ka vërtetuar se paditësja V. K., nga Gjakova, që nga dt.18.04.2017 e deri me dt.23.09.2019 konofrm kalendarëve tanë të punës, ka punuar për gjithsejtë 426 ditë pune.

Sa i përket bazës së kërkesë-padisë, Gjykata vërtetoi faktin e pa kontestuar se që të tre paditësit kanë qenë të punësuar tek e paditura. Paditësja V. K. ka 42 vite përvojë pune. Paditësja F. Q. ka 41 vite përvojë pune si dhe S. K. ka 43 vite përvojë pune. Që të tre paditësit tek e paditura janë pensionuar. Paditësja V. K. nga dt.18.04.2017 e deri me dt.23.09.2019 ka punuar gjithsej 426 ditë pune. Paditësi S. K. nga Gjakova, prej dt.18.04.2017 e deri me dt.28.12.2018 ka punuar për gjithsejtë 310 ditë pune, andaj, gjykata në rastin konkret vërteton se në bazë të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, sipas të cilës dispozitë ligjore në mënyrë decisive është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”,* po ashtu me dispozitat e nenit 35.8 ku citohet se *“Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50% të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75% të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse”. Dhe më tutje, sipas dispozitave të nenit 35.9 “Punëtorët (që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”.*

Duka marr parasysh rrethanat e lartcekura gjykata erdhi në përfundim se kërkesë-padia e paditëses V. K., nga Gjakova është pjesërisht e bazuar, pasi që me rastin e daljes së paditëses në pension me dt. 23.09.2019, ka qenë në fuqi kontrata e sipër cituar e cila ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, andaj paditëses ia ka aprovuar kërkesëpadinë sa i përket tri pagave për përcjellje në pension për V. K. shumën prej nga 482,25€ për një pagë x 3 shumën e përgjithshme prej 1.416.75 €, në kuptim të nenin 35.9 të Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 si dhe 150 % të një page të pagës së fundit në shumën prej 708.37 €, ne kuptim të nenin 35.8 pika 8.4 ku për mbi 40 vite të përvojës së punës paditëses i takon shuma në vlerë 150% të një page bazë, për shkak se kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësja tek punëdhënësi këtu e paditura i ka plotësuar kushtet e shpërblimit, respektivisht ka mbi 40 vite përvojë pune, si dhe kompensimin e ushqimit (shujtave) për periudhën 18.04.2017-23.09.2019, nga dy euro ne dite gjithsejtë për 424 dite pune ne shumen prej 848.00 €, në kuptim të nenit 35 par.7 të kontratës kolektive, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses është aprovuar pjesërisht në shumën e përgjithshme prej 2.973.12 € (dymijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre euro e dymbëdhjetë cent).

Gjithashtu edhe kërkesëpadia e paditëses F. C., nga Gjakova, është e bazuar, pasi që me rastin e daljes së paditëses në pension me dt. 08.01.2019, ka qenë në fuqi kontrata e sipër cituar e cila ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, andaj paditëses ia ka aprovuar kërkesëpadinë sa i përket tri pagave për përcjellje në pension për F. Ç., shumën prej nga 257,52 € për një pagë x 3 shumën e përgjithshme prej 772.56 €, si dhe 150 % të një page të pagës së fundit në shumën prej 386.28 €, për shkak se kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësja tek punëdhënësi këtu e paditura i ka plotësuar kushtet e shpërblimit, respektivisht ka mbi 40 vite përvojë pune, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses është aprovuar në tërësi në shumën e përgjithshme prej 1.158.84 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë e katër cent), ndërsa paditësit S. K. gjykata i ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë sa i përket tri pagave me rastin e pensionimit në shumën prej 487.69€ për një pagë x 3 shumën e përgjithshme prej 1.463.07, shpërblimin jubilar 150% të një page të pagës së fundit në shumën prej 731.53 për shkak se kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësi tek punëdhënësi këtu e paditura i ka plotësuar kushtet e shpërblimit, respektivisht ka mbi 40 vite përvojë pune, si dhe kompensimin e ushqimit (shujtave) për periudhën 18.04.2017-02.01.2019, nga dy euro ne dite gjithsejtë për 298 dite pune në shumen prej 596.00 €, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit është aprovuar pjesërisht në shumën e përgjithshme prej 3.058.80 € (tremijë e pesëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent).

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur, mirëpo pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se Gjykata vërtetoi faktin se paditësit kanë dal në pension gjatë vitit 2019, ndërsa ndërsa Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, është e lidhur dhe e nënshkruar nga MASHT, për punëmarrësin SBASHK-u, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, po ashtu lidhur me planifikimin e buxhetit për pagat e tilla pala paditëse nuk është fajtores lidhur me planifikimin e buxhetit pasi që më këtë merren organet shtetërore, andaj pretendimet të tillë kjo Gjykatë nuk e mori parasysh duke i konsideruar të njëjtat pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadiisë së paditëses V. K., nga Gjakova, për kompensimin e ushqimit ditor – shujtën, për praninë në punë, mbi shumën e aprovuar 848 € për 424 ditë, si në dispozitiv nën I pika 1 të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar 914,00 €, për 457 ditë, gjykata ka vërtetuar se paditësja nga dt.18.04.2017 e gjer me dt.23.09.2019 ka pasur ditë të plota të punës 424 ditë pune dhe jo siq ka kërkuar paditësj për 457 ditë pune, për këtë arsye i është refuzuar kërkesëpadia e paditëses V. K., vetëm për ushqimin ditor shujtat pasi që është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura të Kontratës Kolektive të Arsimit. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadiisë së paditësit S. K. nga Gjakova, mbi shumën e aprovuar 3.058,80 € si në dispozitiv nën I pika 3 e këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar 3.376,80 €, respektivisht shumës mbi shumën e aprovuar, paga përcjellje në pension si dhe për shpërblimin jubilar gjykata të njëjtën e refuzoi ngase konsideroi se shuma e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila është e paraparë me dispozitat ligjore të kontratës kolektive, pasi që paditësi në muajt e fundit para pensionimit ka realizuar pagë në shumën prej 487.69€ për një pagë x 3 shumën e përgjithshme prej 1.463.07 € si dhe për shpërblimin jubilar 150% të një page të pagës së fundit x 487.69 €, në shumën prej 731.53 €, e jo siq ka kërkuar paditësi për paga përcjellëse në pension shumën e përgjithshme prej 1.641.87 €, si dhe për shpërblim jubilar shumën prej 820.93 €. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shuma e kërkuar me kërkesëpadi përtej shumës së aprovuar si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi, nuk është reale dhe se është në kundërshtim me dispozitat e kontratës kolektive të arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht neni 35 të kontratës.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në

marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij". Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*. prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësve në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse i autorizuari i paditësës e ka tërhequr padinë e paditësës F. Q., nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, për kompensimit e ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjer më datë 08.01.2019, për ditët totale të pranisë në punë prej 298 ditë, në shumën prej 596 €, gjykata në kuptim të nenit 261 par.3 lidhur me par. 2 të LPK-së, Nr. 03/L-006. Dt. 30 qershor 2008, vendosi si në dispozitiv III të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit për udhëheqjen e kësaj procedure iu janë pranuar shpenzimet e domosdoshme, siç më poshtë vijojnë: në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi, shuma prej 20,00€, për përpilimin e padisë, shumën prej 208,00 €, për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësve në shqyrtimin kryesor shumën prej 270,40€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 498,40€, siç parasheh 6,7 dhe 10 i TA, ndërsa e refuzojë shumën e mbetur për shpenzime procedurale në lartësi prej 270.40 €, për shkak se seanca ishte shtyrë me kërkesën e të autorizuarit të paditësve dhe e njëjta shumë bie ndesh me nenin 2 par. 1, të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit (datë 23.03.2019), sipas të cilës dispozitë është paraparë se *"Avokati nuk duhet t'i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme"*, si dhe me nenin 4 të LMD-së, i cili parasheh se: *"Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë"*.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:271322, 11.02.2021

Procesmbajtësi

Gjyqtari

Malsor Kryeziu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.